

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK RROGOZHINË

Nr 1186 Prot

Datë 21 / 03 / 2023

Lenda: Rezultatet e Sondazhit të Prioriteteve të Komunitetit të Bashkisë Rrogozhinë

Drejtuar: Z. Edison Memolla, Kryetari i Bashkisë
Z. Rezart Vogli, Drejtor Finance

Për dijeni: Anëtarëve të Këshillit Bashkiak të Bashkisë Rrogozhinë

I nderuar zoti Kryetar,

Këshilli Bashkiak ka organizuar një sondazh për të marrë mendimin/prioritetet e komunitetit për Projektbuxhetin Afatmesëm 2024-2026, i cili ka qenë i publikuar nga 31 Janar deri me 17 Mars 2023 në faqen web dhe në rrjetet sociale të këshillit dhe më gjerë.

Komisioni i Përhershëm i Ekonomisë, i mbledhur më datën **21.03.2023**, shqyrtoi rezultatet e sondazhit për prioritetet e komunitetit për Projektbuxhetin Afatmesëm 2024-2026, nga ku rezultoi se programet/shërbimet më kryesore të votuara nga komuniteti që kërkojnë një vëmendje më të lartë paraqiten si më poshtë:

1. Rrjeti Rugor Rural;
2. Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime;
3. Menaxhimi i Mbetjeve dhe Shërbimet Bujqësore;
4. Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit dhe;
5. Mbështetje për Zhvillim Ekonomik.

Ndërsa të mbahen në të njëjtin nivel shpenzimet për programet si më poshtë:

6. Menaxhimi dhe Administrimi si dhe;
7. Arsimi bazë dhe parashkollor

Këshilli Bashkiak me anë të kësaj shkrese kërkon reflektimin e kërkesave të qytetarëve si pjesë e Projekt Buxhetit 2024-2026 brenda kapaciteteve financiare dhe prioriteteve strategjike të Planit të Përgjithshëm Vendor. Për më shumë informacion lidhur me prioritetet e qytetarëve të Bashkisë Rrogozhinë, bashkëlidhur analiza e detajuar e sondazhit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të përgjigjes tuaj,

Kryetar i Këshillit

Mukades Gixhari

Sekretari i Këshillit

Ervis Shera

Kryetar Komisionit

Enver Memolla

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK RROGOZHINË

ANALIZA E SONDAZHIT NË LIDHJE ME PRIORITETET E PUBLIKUT PËR
PROJEKTBUXHETIN AFATMESËM 2024-2026

QËLLIMI DHE MBARVAJTJA E SONDAZHIT

Ky sondazh ka si qëllim të mundësojë pjesëmarrjen qytetare në vendimarrje duke mbledhur mendimin e komunitetit mbi mënyrën se si bashkia i ka shpenzuar paratë gjatë vitit 2022 si dhe të ndihmojë këshillin bashkiak të kuptojë se cilat janë prioritet kryesore të komunitetit në lidhje me buxhetin afatmesëm 2024-2026. Sondazhi merr mendimin edhe në lidhje me performancën e shërbimeve kryesore si dhe në lidhje me gadishmërinë për të paguar më shumë tarifa për të përmirësuar shërbimet që ofrohen.

Bazuar në rezultatet e këtij sondazhi, Këshilli Bashkiak Rrogozhinë do të mbledhë komisionin e ekonomisë për të shqyrtuar prioritetet që kanë ardhur nga komuniteti dhe do të hartojë një shkresë përcjellëse në lidhje me kërkesat prioritare të komunitetit për shpenzime buxhetore e cila mendohet të ndihmojë administratën në përcaktimin e tavaneve përgatitore.

Pyetjet e sondazhit bazohen në të dhënat faktike të vitit 2022 dhe shpenzimet për shërbimet kryesore gjatë 2023.


Sondazhi është shpallur në faqen zyrtare të bashkisë <http://www.bashkiarrogzhine.gov.al/index.php/17-njoftime-shpallje/51-sondazh-per-percaktimin-e-prioriteteve-te-komunitetit-2024> dhe në rrjetet sociale të Këshillit Bashkiak e më gjerë, më datë 31 Janar 2023 dhe ka qëndruar online deri më datë 17 Mars 2023.

REZULTATET E SONDAZHIT

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME


Nga data 31 Janar e deri më datë 17 Mars 2023, **105 persona** kanë plotësuar sondazhin nga 5 Njësi Administrative të ndryshme (Rrogozhinë, Kryevidh, Sinaballaj, Lekaj dhe Gosë), ndër të cilët **58 meshkuj** dhe **47 femra**.

● Femër	47
● Mashkull	58




Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në sondazh vijnë nga Njësia Administrative Rrogozhinë. Pesë Njësi Administrative janë të përfaqësuara nga anëtarë të komunitetit që kanë mbushur këtë sondazh. Për më shumë informacion paraqet tabela më poshtë:

● Rogozhinë	57
● Kryevindh	12
● Sinaballaj	9
● Lekaj	12
● Gosë	15




Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve 39% i përkasin grupmoshës 18-30 vjeç, ndjekur nga mosha 31-45 vjeç me 36%, me 18% mosha nga 46-60 vjeç dhe 7% grupmosha mbi 60 vjeç.

● 18-30 vjeç	41
● 31-45 vjeç	38
● 46-60 vjeç	19
● mbi 60 vjeç	7



Pjesëmarrësit vijnë nga sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Sipas sondazhit, paraqiten me numrin më të lartë të cilët kanë dhënë mendimin e tyre sipas: sektori publik me 51 persona, ndjekur nga të vetëpunësuar me 16 persona, sektori privat dhe të papunë me 11 persona respektivisht, student 9 persona, tjetër me 6 persona, dhe punonjës OJF/ Akademik 1 person.


● I vetë punësuar	16
● I punësuar në sektorin privat	11
● I punësuar në sektorin publik	51
● Punonjës OJF/Akademik	1
● Student	9
● I papunë	11
● Tjetër	6



Ndërsa për pyetjen 5 ku bëhet fjalë për kategori të përfshirjes sociale të cilët marrin ndihmë ekonomike dhe kategoria me aftësi ndryshe, i janë përgjigjur 10 persona, nga ku: 7 prej tyre bëjnë pjesë në kategorinë e ndihmës ekonomike dhe 3 persona me aftësi ndryshe.


[Handwritten signatures in blue ink]

- Merni ndihmë ekonomike 7
- Person me aftësi ndryshe 3



OPINIONI NË LIDHJE ME SHPENZIMET BUXHETORE PËR SHËRBIMET KRYESORE

■ Jam dakort ■ Duhet shpenzuar më shumë ■ Duhet shpenzuar më pak ■ Nuk e di



Sikurse vihet re nga grafiku ka një dakordësi të shumicës së pjesëmarrësve që shërbimi Strehimi Social, Ujësjetllës Kanalizime dhe Shërbimet Publike, janë prioritate nga lista e programeve/shërbimeve kryesore dhe duhet që administrata të vendosë më shumë fonde. Ndërkohë, administrata duhet të mbajë në të njëjta nivele programet e Arsimit Bazë dhe Parashkollor si dhe Menaxhimi dhe Administrimi.


PRIORITETET E KOMUNITETIT NË LIDHJE ME BUXHETIN 2024

Sikurse duket nga përgjigjet e pyetjes se për cilat shërbime duhet shpenzuar më shumë, programet me prioritet për komunitetin janë:

1. Rrjeti rrugor rural me 15 përgjigje;
2. Furnizimi me ujë dhe kanalizime me 13 përgjigje;
3. Menaxhimi i mbetjeve me 12 përgjigje;
4. Shërbimet bujqësore me 12 përgjigje;
5. Menaxhimi i infrastrukturës dhe ujitjes dhe Mbështetje për zhvillim ekonomik me 9 përgjigje;
6. Shërbimet publike vendore me 8 përgjigje;
7. Transporti Publik me 7 përgjigje;
8. Administrimi i pyjeve dhe kullotave dhe tjetër me 5 përgjigje.
9. Përkujdesi social me 4 përgjigje;

10. Planifikimi Urban Vendor me 3 përgjigje;
11. Arsimi Bazë dhe Parashkollor, Arsmi i Mesëm i Përgjithshëm dhe Sport dhe Argëtim me nga 2 përgjigje;
12. Trashëgimia kulturore dhe Tjetër me nga 1 përgjigje;

● Shërbimet e Policisë Vendore	0
● Shërbimet Bujqësore, Inspektimi...	12
● Mbështetje për Zhvillim Ekono...	9
● Menaxhimi i Infrastrukturës së U...	9
● Rrjeti Rrugor Rural	15
● Administrimi i Pyjeve dhe Kullot...	5
● Transporti Publik	7
● Menaxhimi i Mbetjeve	12
● Planifikimi Urban Vendor	3
● Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime	13
● Shërbimet Publike Vendore	8
● Shërbimet e Kujdesit Parësor	0
● Sport dhe Argëtim	2
● Trashëgimia kulturore, Eventet A...	1
● Arsimi Bazë përfshirë Arsimin Pa...	2
● Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm	2
● Përkujdesi Social	4
● Tjetër	1



Si rezultat shërbimet me prioritare ku bashkia duhet të ketë në vëmendje dhe të shpenzojë më shumë para sipas qytetarëve janë:

1. Rrjeti Rrugor Rural;
2. Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime;
3. Menaxhimi i Mbetjeve dhe Shërbimet Bujqësore;
4. Menaxhimi i Infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit dhe;
5. Mbështetje për Zhvillim Ekonomik.

GADISHMËRIA PËR TË PAGUAR MË SHUMË TAKSA PËR SHËRBIMET KRYESORE

Në 105 pjesëmarrës në sondazh, 67 pjesëmarrës janë shprehur kundër pagesës së më shumë taksave për bashkinë dhe 18 pjesëmarrës janë shprehur pro pagesës për më shumë taksa. Pjesa tjetër nuk ka votuar.